

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

C-I.-12-0056

Paditësit

1. **M.C.**, me seli në X dhe
2. **NTSH X**, me seli në X, me pronar Zj.N.E. nga X,
të cilët i përfaqëson B.M., Avokat nga X

Kundër

E Paditura

Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rruga Ilir Konushevc 8, Prishtinë

Kolegji i specializuar 1 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga Esmë Erterzi, gjyqtare kryesuese, Shkelzen Sylaj dhe Hysen Gashi, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15.05. 2013, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Padia hedhet poshtë si e papranueshme

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më 23.11.2012 Paditësit parashtruan një padi duke kërkuar anulimin e Vendimit paraprak të lëshuar nga e paditura me 16.12.2011 dhe atij përfundimtar me 31 maj 2012 për tërheqjen e aksioneve mbi asetet e Nder e Re H.G., Sh.p.k., e privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me “spin-of special” më datë 10 gusht 2006. Paditësit pohojnë se u janë dëmtuar rëndë të drejtat pronësore në Ndr. e Re H.G. pasi bashkarisht kanë paguar pjesën prej 60% të çmimit të tenderit (shumen prej 5.003.800,00 € nga shuma e përgjithshme prej 8.160.000,00 €) për privatizimin e kësaj ndërmarrje. Kanë shtuar se të drejtën pronësore në këtë ndërmarrje e kanë fituar në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit të dt. 22 dhe 28.12.2006 respektivisht të muajit janar 2007 (lidhur me blerësin e Ndr. së Re U.C.).

Paditësi pohojnë se me kërkesën nr.01/12 dt. 03.01.2012, kanë kërkuar nga AKP respektivisht nga Bordi i AKP-së që ta rishqyrtojë dhe ta anulojë vendimin e dt.16.12.2011 për tërheqjen e aksioneve, mirëpo AKP e ka anashkaluar kërkesën e tyre për shkaqe të panjohura për paditësit.

Paditësit deklarojnë se kanë interes juridik që tu pranohet e drejta e tyre pronësore si aksionar te Ndërmarrjes së Re H.G. Sh.P.K, pasi që e paditura nuk iu ka pranuar paditësve statusin e aksionarëve në këtë Ndërmarrje.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës në DHP.

Arsyetimi Ligjor

Padia duhej të hidhej si e papranueshme.

Neni 6 i Ligjit për Dhomën e Posaçme thotë:

- 1. Çdo person që kundërshton një vendim apo veprim të Agjencisë, i cili është ndërmarrë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtojë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se nëntë (9) muaj pas datës kur ai person ka ditur, ose me vëmendje të arsyeshme do të duhej të kishte ditur për atë vendim apo veprim. Çdo kërkesë apo ankesë e tillë duhet përcjellë me prova që personi që parashtron një kërkesë apo ankesë të tillë i ka bërë një njoftim Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së parashtrimit, mbi qëllimin e atij personi që të parashtojë një kërkesë apo ankesë të tillë. Dhoma e Posaçme nuk do të pranojë kërkesën apo ankesën e tillë nëse nuk përcillet me ato 9 prova, ose e cila parashtrohet pas kalimit të periudhës kohore të përmendur prej nëntë (9) muajsh.*
- 2. Çdo person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, që është ndërmarrë në datën apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtojë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (120) pas datës në të cilën vendimi apo veprimi i është dorëzuar personit në fjalë, ose, nëse një dorëzim i tillë nuk kërkohet me ligj, apo nëse dorëzimi i tillë nuk ka qenë i mundshëm apo i arritshëm përkundër përpjekjeve në mirëbesim nga Agjencia, i shpallur në pajtim me politikat operacionale të Agjencisë dhe dispozitat e nenit 10.3 të Ligjit mbi AKP-në. Dhoma e Posaçme nuk do të pranojë, si dhe do të refuzojë, secilin kundërshtim që parashtrohet pas kalimit të periudhës së përcaktuar prej njëqind e njëzet ditësh (120).*

Padia e paditësve për anulimin e Vendimit paraprak të lëshuar nga e paditura me 16.12.2011 dhe atij përfundimtar me 31 maj 2012 për tërheqjen e aksioneve mbi asetet e Nder e Re H.G., Sh.p.k, e privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me “spin-of special” më datë 10 gusht 2006 është e paafatshme.

Nga pohimet dhe nga shkresat e Paditësve të datës të dt. 03.01.2012, 11.06.2012, 14.06.2012 dorëzuar tek e AKP si dhe nga përgjigjja e AKP e datës 22.06.2012 drejtuar përfaqësuesit të paditësve gjykata ka konstatuar se paditësit kanë ditur për vendimet dhe veprimet e AKP për tërheqjen e aksioneve mbi asetet e Nder e Re H.G., Sh.p.k.

Vendimi i fundit i Agjencisë është i datë 31.05.2012. Paditësit do të duhej të paraqisnin një kundërshtim kundër tij në DHP brenda afateve të paraparë sipas nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme. Padia është dashur të parashtrohet brenda 120 ditëve duke filluar më së largu nga data 14.06.2012 kur paditësit janë njoftuar në lidhje me vendimin e AKP-së.

Pasi që paditësit dështuan ti përmbahen afatit për paraqitjen e kundërshtimit ndaj vendimit të AKP-së , gjykata vendosi si në dispozitiv.

Shpenzimet e Gjykatës

Gjykata nuk cakton shpenzimet e gjykatës pasi që presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka lëshuar një listë me shkrim të aprovuar nga Këshilli gjyqësor i Kosovës (Neni 57 Paragrafi 2 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), Kjo do të thotë se deri më tani nuk asnjë bazë të mjaftueshme për caktimin e shpenzimeve gjyqësore.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet apel brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Apeli duhet t'i dërgohet edhe palëve tjera dhe të dorëzohet tek Kolegji Gjykues **nga ankuesi** brenda 21 ditësh. Apeluesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar apelin edhe palëve tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur apeluesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i apelit do të refuzoj apelin si të papranueshëm nëse apeluesi dështon të parashtroj atë brenda afatit të paraparë.

I padituri mund të parashtroj përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar apeli, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek apeluesi si dhe tek palët tjera.

Apeluesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në apelin e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e apeluesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek apeluesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Esma Erterzi, Gjyqtar Kryesues